



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.43, datë 09/05/1995

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 09.05.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike “Propozimin për kthim në fond banese të disa rasteve të bodrumeve”,

**V E N D O S I;**

1. Të miratojë kalimin në fond banese vetëm për rastet kur bodrumet plotësojnë kërkesat e paraqitura nga ky relacion, pra kur,
  - a) Bodrumi të plotësojë kushtet higjeno – sanitare për banesë me vërtetim të lëshuar nga Drejtoria Higjenës dhe Epidemiologjisë dhe nga NK – Banesa.
  - b) Me vërtetim të lëshuar nga NK – Banesa ku të vërtetohet se ky bodrum nuk ka kontratë të ndonjë personi tjetër.
  - c) Banorët që jetojnë aty janë të rregjistruar në Bashkinë e Tiranës si të pastrehë.
2. Të kalojë në fond banese bodrumin që ndodhet në Bulevardin Zhan D’Ark, Pallatet e Lanës, P.1, shk.1, ap.1/1 pasi plotëson kushtet e mësipërme.
3. Të pajisi me autorizim qytetarin Roland Velko i cili është banor në këtë bodrum për 2 dhoma + 1 kuzhinë në këtë adresë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**

**KY VENDIM ËSHTË FOTOKOPJE!**